

PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **19.11.2019**, me fillim në ora **10:10**.
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes të gjithëve, nënkryetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, përfaqësuesit e KFOR-it, OSBE-së, të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm. Të nderuar anëtarë të KPF-së për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Shqyrtimi i Propozim Vendimit për nismën e Bashkëpunimit Ndërkomunal Ndërkombëtar mes komunës së Rahovecit dhe Bashkisë së Vlorës,**
3. **Shqyrtimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit për vitin 2020,**
4. **Shqyrtimi i Planit Lokal të Veprimit për përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunën e Rahovecit 2019-2021,**
5. **Shqyrtimi i Planit Komunal për Integrimin e Qëndrueshëm të Personave të riatdhesuar në komunën e Rahovecit 2019-2022,**
6. **Shqyrtimi i Planit Komunal të Veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhjen e qëndrueshëm 2019-2021,**
7. **Të ndryshme.**

Kryesuesi – Të nderuar anëtarë të KPF-së, a jeni për këtë rend dite? Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar – A ka dikush diçka rreth procesverbalit, nëse jo atëherë e qesim në votim, konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për nismën e Bashkëpunimit Ndërkomunal Ndërkombëtar mes Komunës së Rahovecit dhe Bashkisë së Vlores – Për këtë pikë e ftoj Nënkryetarin e Komunës z.Iska!

Fatmir Iska – I nderuar Kryesues, te nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, përfaqësues të OSBE-së, të KFOR-it, gjithë ju të pranishëm, e përmendi edhe Kryesuesi një nismë për bashkëpunim ndërkomunal ndërkombëtar, ideja është që të binjakëzohemi me Bashkinë e Vlorës, pra janë të cekura edhe fushat e bashkëpunimit që do të jenë ekonomia, kultura, arsimi, shëndetësia, sporti. Ne kemi pasur edhe bashkëpunime tjera me Bashkitë ose Komunitat e tjera me Shqipërinë që është rasti me Bashkinë e Përmetit dhe ideja është që të binjakëzohemi edhe me Bashkinë e Vlorës. Bashkëpunimi do të jetë i dyanshëm, kjo është vetëm një nismë pastaj procedurat janë edhe me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal merr kohë edhe kjo deri te finalizimi i aktit ose marrëveshjes së binjakëzimit me Bashkinë e Vlorës, nuk dua të

zgjatëm më shumë sepse edhe ju keni të diskutojmë, këtë pikë e diskutojmë edhe në seancën e Kuvendit dhe besoj që të gjithë do të pajtohemi me këtë nismë por edhe me procedura tjera deri te akti i finalizimit të kësaj marrëveshje ndërkomunale ndërkombëtare të komunës së Rahovecit me Bashkinë e Vlorës. Ju faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë Nënkryetar a ka dikush diçka, urdhëroni z. Fazliu!

Rasim Fazliu – Faleminderit Kryesues, përshëndetje për juve, Nënkryetarin, anëtarët e KPF-së, drejtorët prezentë, përfaqësues të LMT-së, OSBE-së, të mediave dhe ju gjithë të pranishëm në këtë sallë. Unë mendoj se kjo është një nismë e mirë pra është mirë të bashkëpunojmë sidomos me një qytet i cili ka traditë goxha të madhe në përgjithësi në të gjitha fushat siç e përmendi Nënkryetari i Komunës, e mbështesim këtë nismë, tash mbetet të procedohet më tutje çështja të bisedohet edhe me ata atje edhe shpresojmë se do të lidhet një bashkëpunim në mes të komunës së Rahovecit dhe Bashkisë së Vlorës, desha pak të lidhem te pika e dytë që thotë bashkëpunimi ndërkomunale do të zhvillohet me komunat e Ministrisë si në vijime pastaj përmendet këtu 2.1 Komunën e Rahovecit Republika e Kosovës edhe 2.2 Bashkinë e Vlorës Republika e Shqipërisë, pra pse ekziston termi Ministri apo ashtu duhet të jetë. Faleminderit!

Nënkryetari – Është cekur bashkimin që e bëjnë ose marrëveshjen që e arrijnë mbi bazën e kësaj nisme që fillojmë nga sot d.m.th. si dokumente janë dy komuna ose dy Bashki nëse mund të quajmë pastaj zhvillohen këto procedura, nuk është si më herët që ka qenë ka rrjedhë akti prej komunës edhe ka ndodhur binjakëzimi si me Bashkinë e Përmetit që ka ndodhë, tash zhvillohen edhe disa procedura ku Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e shqyrton njëherë ligjshmërinë a është në rregull pastaj ajo në finale e vendos a është krejt në rregull apo jo pra vetëm për këtë arsye ceket këtu edhe Ministria.

Kryesuesi – Faleminderit Nënkryetar, tjetër dikush? Atëherë pasi që nuk ka tjetër të lajmëruar, konstatoj që kalon për Kuvend pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit për vitin 2020
– Për këtë pikë e ftojë Drejtorin e Shëndetësisë z. Samir Mustafa !

Samir Mustafa – Përshëndetje për të gjithë, dukë u bazuar në nenin 11 dhe 13 të ligjit për vetëqeverisje lokale dhe statusit të Komunës, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit më të cilin i lejohet Kryetarit të Komunës që në interes të qytetarëve në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit të lidh marrëveshje bashkëpunimi me të gjitha bashkësitë fetare të Komunës së Rahovecit duke u bazuar komfor planit buxhetor afatmesëm. Pakoja e shërbimeve primare do të definohet me një marrëveshje të re e cila nuk do të ketë koston më të lartë se 200 euro për një raste ndërsa për shërbime tjera të cilat nuk janë pjesë e marrëveshjes qytetarët do të paguajnë vetëshërbimet të cilat janë pjesë e marrëveshjes në asnjë raste nuk mund të kushtëzohen nga pagesat e anëtarësive fetare. Ju ftojë që propozimin e Kryetarit ta miratoni!

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, urdhëroni z. Fazliu!

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, ne nga viti në vitë vazhdimisht e kemi këtë pikë të rendit të ditës dhe është mirë që e kemi edhe mendoj se në çastin kur është marrë ky vendim për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për të gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit, mendoj që ka qenë një ndër vendimet ma të mira dhe që e kanë përqafua e kanë përkrahë qytetarët e Komunës së Rahovecit edhe është diçka shumë e mirë që ka ndodhë dhe në përgjithësi e mbështesim këtë por paska pak ndryshim karshi vendimit të vitit të kaluar sepse ne e dimë që çmimi pak po evoluon herë po bëhet 200 e herë 180 e herë 190 por sigurisht në bazë të çmimeve në treg që janë po ashtu një ndryshim koka këtu te lloji i shërbimit p.sh. te qefini ka qenë 20 euro kurse tani është 25 euro pra për 5 euro ka ngritje pastaj kujdestaria ka qenë 10 euro kurse tash është 15 euro dhe e bënë ndryshimin prej 190 eurove në 200 euro, pra në përgjithësi është një vendime i mirë që kemi marrë edhe e përkrahim këtë edhe besoj që në Kuvend do të kalon. Ju faleminderit shumë!

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Fazliu për kontributin, tjetër dikush, urdhëro z. Cena!

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit edhe unë mendoj se ky shërbim që komuna ju bën qytetarëve tanë është një shërbim i cili është i qëlluar edhe është i pranuar nga të gjitha komunitetet edhe natyrisht edhe ne mendojmë që të përkrahim këtë propozime edhe në vazhdim pra komuna të vazhdoj t'i ndihmoj qytetarëve, vetëm se te forma e përpilimit të këtij propozimi po mendoj edhe pse ne e dimë se kur është bërë planifikimi i buxhetit për vitin 2020 edhe korniza afatmesme buxhetore, pozicioni i shpenzimeve ndoshta është mirë edhe këtu të cekët sa e di unë, nga mallrat dhe shërbimet që do të

shfrytëzohet, mirë është të figuroj në këtë dokument përndryshe sa i përket asaj që foli Rasim Fazliu për shtesë prej 10 euro kjo qëndron, po tash ne besojmë që ata që i kanë bërë këto kalkulime ndoshta kanë qenë të arsyeshme dhe nuk është ndonjë ndryshim i madh për 10 euro megjithatë mendoj se është propozimi që ne duhet të përkrahim që të vazhdoj ky shërbim edhe me tutje për qytetarët e komunës tonë. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shumë z. Cena, tjetër dikush, urdhëro z. Çadraku!

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, përshëndetje për Nënkryetarin, kolegët, mysafirët monitorues. Unë sigurisht që pajtohem edhe me parafolësit edhe me propozimin që është shumë i mirë dhe shumë i vlefshëm dhe i domosdoshëm për qytetarët, por, unë kam diçka tjetër që këtu nuk figuron, e që mendoj se është e rëndësishme për tu theksuar, në qoftëse është e domosdoshme që edhe në Kuvend të vendoset kjo. Është një problem këtu që njerëzit i marrin këto shërbime mirëpo pastaj nuk bëhet ç’regjistrimi i atij banori i cili ka ndërruar jetë. Unë mendoj që është mirë me futë në këtë propozim që, këta që i marrin këto shërbime pra që paguhen për këto shërbime, ta bëjnë edhe këtë shërbim, që ta bëjnë ç’regjistrimin e banorit që ka vdekur sepse po mbesin kështu në numër të regjistrimit edhe pastaj po kemi probleme afatgjate deri sa dikujt, atij një detyrë pra një punë për të kryer edhe i duhet domosdoshmërisht të shlyej, përndryshe vullnetarisht nuk shkojnë njerëzit me kryer këtë obligim qytetar i cili është i domosdoshëm prandaj unë mendoj që është mirë me futë edhe këtë propozim që të jetë obligative edhe në këtë drejtim. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Çadraku, tjetër dikush? Urdhëro Nënkryetari!

Nenkryetari – Te kodi, unë pajtohem me doktorin që duhet me qenë një paragraf shtesë ku sigurohen mjetet për këtë lloj të shërbimit ndërsa te kjo z.Çadraku, që po e përmend d.m.th. funksionon kështu sepse ne jemi takuar edhe kryetarin e Bashkësisë Islame, e kemi diskutuar edhe specifikacionin për arsye të ngritjes së çmimeve, këtë vit 2019 që jemi për një rast të shërbimit të varrimit është 190 euro, kurse për vitin 2020 e kemi 200 euro plus 10 euro edhe kemi diskutuar në specifikacion ngritja e çmimit tek pëlhuara, dezinfektimi d.m.th. variojnë çmimet prej vitit në vit. Te kjo pjesë ku ju thuani se duhet me u çregjistrua, unë pajtohem për arsye se edhe ne kishim telashe edhe në këto zgjedhjet e fundit që kishim para një muaji e gjysmë edhe shumë të vdekur kishin të drejtë vote pra gjithë pajtohemi këtu se janë të gjitha gabime por funksionon në këtë formë d.m.th. çdo vdekje që është, familjari është i obliguar me e lajmërua në bashkësinë fetare edhe e merr një vërtetim prej bashkësisë fetare vjen në komunë dhe automatikisht çregjistrohet, me herët kishin telashe këta pensionet që merreshin me i shfrytëzua me shumë se një muaj mirëpo kjo automatikisht ndodhe pastaj te kjo pjesa tjetër që e përmenda më herët është krejt komplet diçka tjetër. Ne momentin që bashkësia islame merr vërtetimin e vdekjes lajmërohet në komunë automatikisht ndodhë çregjistrimi i të vdekurit d.m.th. menjëherë regjistrohet ne komunë edhe thjesht konsiderohet si i vdekur kurse pastrimi i listave tjera është krejt diçka tjetër, ata kanë pengesa në raste të veçanta që nuk dua me i përmend, të vdekjet e natyrshme është normale doktori është aty merret një vërtetim atje i vdekjes ndërsa te këto rastet tjera të veçanta me problematika tjera zakonisht bashkësitë fetare kanë telashe për arsye se deri sa te vendoset ose të konstatohet ajo vdekje që mund të jetë e kryen shërbimin mirëpo pagesa vonohet edhe kjo pastaj ne krejt muajin i shkakton telashe në vonesa, deri në këtë momente që po flasim si komunë kemi qenë shumë të rregullte në pagesa ndaj bashkësive fetare që i kanë krye këto shërbime, shpresojmë që kanë me vazhdua përpos këtyre muajve të fund vitit ku të hyrat barten, mos alokimi i buxhetit në vitin e parë te vitit vijues që vjen janari d.m.th. ka vetëm aty këto pengesa përndryshe kjo automatikisht çregjistrohet, besoj që nuk kemi nevojë që këtë pjesë të qesim në vendim për arsye se është e rregulluar me normativa tjera ligjore. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë nënkryetar, tjetër dikush, atëherë më qe nuk ka tjetër konstatoj se kalon për kuvendë pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Planit Lokal të Veprimit për përfshirjen e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Rahovecit 2019-2021 – E ftoj z. Lendrit Qeli- udhëheqës në sektorin për kthim për komunitete!

Lendrit Qeli – Faleminderit Kryesues, i nderuar Nënkryetar, të nderuar anëtarë të KPF-së, të nderuar përfaqësues nga KFOR-i, OSBE-ja, zonja dhe zotërinjë, më lejoni që të ju prezantojë tre planet e veprimit për të cilin dy të parat sa i përket kthimit, meqenëse kemi të bëjmë me planin e veprimit për komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian e cila deri vonë nga strategjia për përfshirjen e komuniteteve në fjalë, komuna e Rahovecit në këtë drejtim ka qëndruar pak me vonesë për shkak të disa sfidave që është ballafaquar zyra

komunale për komunitete dhe kthime në mungesë të udhëheqësit të zyrës dhe menjëherë në momentin e parë prej se kam pranuar këtë detyrë jam munduar që ti trajtojë çështjet në fjalë e sidomos planin e veprimit falë disa organizatave ndërkombëtare, ne kemi arritur të kompletojmë planin e veprimit i cili ka një kosto buxhetore për të cilin në muajt dhe ditët që ne po i kalojmë tashme kjo veç po implementohet sa i përket implikimeve buxhetore përmes drejtorive të ndryshme brenda komunës tonë por në të njëjtën kohë vlen të theksohet që në kuadër të planit të veprimit neve kemi planifikuar të realizojmë edhe një konferencë të donatorëve të cilin edhe mjetet e tjera do të sigurohen nga organizatat e ndryshme përfshirë këtu edhe ambasadat të cilën kemi një konfirmim zyrtar për mbështetje dhe po uroj që kjo do të ketë edhe mbështetjen tuaj në KPF. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit z Lendrit, a ka dikush diçka, urdhëroni z. Cena!

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, në fakte ne përfaqësues të Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi mbajtur edhe një punëtori para disa dite në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës do të thotë për planin e veprimit për përfshirjen e Komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian e organizuar nga OSBE-ja e aty ka prezantuar edhe Lendriti si përfaqësues i Zyrës Komunale për Kthim të Komunitete, atë ditë janë sqaruar disa gjëra, ne kemi diskutuar edhe ne si anëtare të Komitetit për Politikë dhe Financa në diskutim, e kemi dhënë mendimin aty edhe këtu po e japim mendimin, unë personalisht së paku që në fakte është një planë kështu gjithëpërfshirës edhe i ka përfshije gjitha ato kryesore ato fushëveprimet ma të rëndësishme që edhe unë mendoj se është dashtë ashtu mirë të përfshihen siç është arsimi, shëndetësia, banimi, politika sociale, natyrisht ne jemi të vetëdijshëm se këto janë sfida sociale me të cilat ballafaqohen të gjitha komunitetet jo vetëm komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian mirëpo jemi të vetëdijshëm gjithashtu që ky komunitet i ka shënua disa hapa karshi komunitetit shumicë dhe komuniteteve tjera kështu që besoj që plani do të jetë ndihmesë në këtë aspekte, unë mendoj që ne duhet të përkrahim planin kështu si është pjesën teorike këto aktivitetet gjithashtu janë të përfshira shumë mirë për arritjen e këtyre objektivave e tek pjesa e buxhetit aty nuk është diskutuar edhe aq, unë besoj që komuna duhet të shiqojë që ajo pjesa që i takon që është barrë e komunës sepse sa e kemi parë ne, në plan në fakt janë edhe të tjerë akterë që marrin pjesë në buxhet që është edhe niveli qendror e që mendohet edhe për donatorët mirëpo komuna besoj që do të shikoj që sa janë këto shpenzime racionale të arsyeshme, për mbledhjen e kuvendit ndoshta do të kemi një qartësi më të madhe pikërisht nga ana e komunës nga e cila pjesë e buxhetit është ndarë kjo pjesë e buxhetit apo nuk është ndarë, në mënyrë që ne si kuvendarë me ditë saktësisht a do të ketë para apo nuk do të ketë, a do të ballafaqohet ky program me pengesa apo jo, edhe ne për me qenë më afër asaj se ne duhet tek e fundit me aprovua mirëpo arsyeshmëria duhet të jetë me e mirë edhe shpjegimi gjithashtu më i qartë për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Cena, tjetër dikush, urdhëroni z. Fazliu!

Rasim Fazliu – Faleminderit Kryesues, e falënderoj përfaqësuesin e zyrës komunale për komunitete për paraqitjen e planit lokal të veprimit gjegjësisht draft planin para nesh, mendoj që ky draft plan i veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian është goxha gjithëpërfshirës edhe është mirë se i përfshin disa fusha të rëndësishme siç është arsimi, punësimi edhe mirëqenia sociale, shëndetësia, banimi. Unë mendoj që mirë që Qeveria e Kosovës në vitin 2017 e ka hartuar strategjinë për këto komunitete ndoshta jemi të vonuar në këtë drejtim në kuptimin që është dashur edhe më herët të marrë veprime me bo integrimin e qytetareve tanë të Kosovës kështu që megjithatë nuk është vonë edhe tash duhet të gjejmë forma dhe mënyra të bëhet integrimi sa më i mirë në të gjitha këto fusha që i përmendem sepse jemi dëshmitarë të asaj që ngecin edhe në arsim p.sh. sidomos këto komunitete hezitojnë ose nuk i qojnë në shkollë ata vet prindërit ose për arsye të caktuara ekonomike etj. prandaj është mirë me ju dal në ndihmë, plani është i mirë dhe besoj që në kuvend kemi me kalua kështu që edhe njëherë faleminderit.

Kryesuesi – Faleminderit z.Fazliu, urdhëro zj. Lushi!

Fahrie Lushi – I nderuar kryesues, i nderuar Nënkryetar, të nderuar kolegë këshilltarë dhe gjithë të pranishmit. Mendoj edhe unë disa fjalë sepse i përmendem ndoshta të gjitha detajet mirëpo e rëndësisë së veçantë ky plan dhe që e bën mjaftë të arsyeshëm dhe të rëndësishëm si plan i tillë i veprimit është çështja e ndjeshme e arsimit ku thuhet brenda këtij plani se fëmijët e këtij komuniteti mbeten anash ose mbeten jashtë dy kategorive që janë më se të ndjeshme që janë arsimit parafillor ku thuhet se në bazë të statistikave se

fëmijët e këtij komuniteti nuk kanë asnjë d.m.th. nuk shënohet asnjë nxënës nga këto komunitete po ashtu pas mbarimit të arsimit fillor shumica e vajzave ose asnjë vajzë nuk e vazhdon shkollimin e mesëm të paktën në komunën tonë dhe po ashtu është çështja e ndjeshme edhe ajo tek arsimi i lartë tek universiteti madje shihet edhe papunësia ose çështja tjetër e ndjeshme ku nuk mund të punësohen në administratë publike sepse mungon kualifikimi i tyre. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë zj.Lushi,tjetër dikush, atëherë më qe nuk ka tjetër të lajmëruar konstatoj se kalon edhe pika e katërt e rendit të ditës.Kalojm në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Planit Komunal për Integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Komunën e Rahovecit 2019-2022 – Gjithashtu edhe për këtë pikë e ftojë z. Lendrit Qeli!

Lendrit Qeli – Faleminderit Kryesues, ne kuadër të planit komunal për integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar që është planifikuar të realizohet për vitin 2019-2022, ky plan i veprimit derivon kryesisht nga Ministria e Punëve të Brendshme të cilit ekskluzivisht merret me personat e riatdhesuar dhe në kuadër të nivelit lokalë është barrë e zyrës komunale për komunitete dhe kthim por që në komunën tonë ashtu siç e thashë edhe më herët për shkak të disa problematikëve dhe sfidave që është ballafaquar zyrja, momentalisht këtë kompetencë e ushtron zonja Habibe Haxhimustafa të cilën për shkak të kapaciteteve që zyrtarët tanë nuk e kanë momentalisht dhe barrierave ne gjuhë serbe në shqipe sepse numri kryesisht i të riatdhesuarve vie nga komuniteti shqiptarë pastaj pason nga komunitete e tjera, ky është një planë i veprimit të cilin kërkohet nga Ministria e Punëve të Brendshme të aprovohet nga ana jonë sepse me një farë mënyre ne si nivele komunale bëjmë vetëm punën administrative ndërsa implementimin e saj mjetet dhe mbështetjen financiare e bën direkt Ministria e Punëve të Brendshme. Vlen të theksohet që momentalisht ky plan i veprimit nuk ka ndonjë komplikim buxhetor por që në të ardhmen me decentralizimin e fondeve do të ndahen nëpër nivele komunale në mënyre që efekti të jetë më i mirë karshi personave të riatdhesuar.

Ashtu siç e thash edhe më herët ka një kohëzgjatje për vitin 2019-2022 dhe objektivat gjithashtu edhe aktivitetet të cilët janë të parapara në kuadër të këtij plani të veprimit, tash ne i bëjmë punët rutinë pothuajse çdo ditë dhe në një farë mënyre kjo është edhe një kërkesë shtesë nga MSA-ja dhe jemi te detyruar që pothuajse me nguti ta paraqesim para jush sepse është një obligim ligjor dhe uroj që edhe ky plan i veprimit të merr miratimin tuaj. Faleminderit

Kryesuesi – Faleminderit shumë z.Lendrit, a ka dikush diçka rreth pikës së pestë të rendit të ditës? Atëherë nëse nuk ka të lajmëruar për këtë pikë konstatoj se kalon për Kuvend. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës :

6. Shqyrtimi i Planit Komunal të Veprimit për të Zhvendosurit dhe Zgjidhjen e Qëndrueshme 2019-2021 – Gjithashtu edhe për këtë pikë e ftoj z.Lendrit Qeli!

Lendrit Qeli – Faleminderit përsëri Kryesues edhe ky plan i veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhjen e qëndrueshme tashmë është duke u implementuar në komunën tonë pothuajse të gjitha aktivitetet qe ne realizojmë si Zyrë, ne këtë drejtim qëndrojmë pak më mirë sepse ky program menaxhohet direkt nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe në bashkëpunim me Bashkimin Evropian e posaçërisht ku Komuna jonë është pjesë e programit RLKP-së që menaxhohet nga IOM-i në Kosovë, ky program parasheh rol të qëndrueshëm për personat e zhvendosur në tri shtete të rajonit pra ka të bëjë kryesisht me Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Malin e Zi. Momentalisht ky proces po ecë mirë në Komunën tonë, kemi 16 raste në këtë drejtim dhe që po ndërtohen shtëpitë dhe po ashtu ky plan i veprimit menaxhohet kryekëput nga Ministria për Komunitete dhe Kthime dhe neve si komunë jemi detyruar që vetëm përmes punëve administrative që i bëjmë dhe aktiviteteve tjera përcjellëse përmes komisioneve që të implementohet në mënyrën ma të mirë të mundshme. Pra edhe kjo është një kërkesë nga Ministria për Komunitete dhe Kthim pra është një obligim ligjor që neve jemi të detyruar të paraqesim para anëtareve të KPPF-së dhe uroj të kemi miratimin tuaj. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit Lendrit, a ka dikush diçka rreth pikës se gjashtë, po urdhëroni z. Cena!

Fehmi Cena – Faleminderit, tash kur na jep fjalën është mirë pak edhe me na pritë sepse veç jemi duke menduar se apo e marrim apo jo fjalën se paksa si shpejt, menjëherë po kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës edhe pse mendoj se nuk është diçka të veçantë me fol sepse këto të tri plane faktikisht ndërlihen në mes vete sidomos këto dy të fundit për kthim të të zhvendosurve por ndoshta kemi ndonjë pyetje sa për


qartësim në mënyrë që kur të bëhet në Kuvend ti kemi ne si Komitet për Politikë dhe Financa më të qarta. E kuptojmë që këto dy plane të fundit që i prezantove në të vërtete janë obligim sigurisht që rrjedhin nga shteti dhe ne pajtohemi plotësisht sepse gjitha këto janë kategori pra janë qytetarët tanë dhe Komuna duhet me i zbatua ato në mënyrë që të ofrojë jetesë të gjithë komuniteteve duke përfshirë edhe shumicën edhe pakicën në mënyrë të barabartë. Ne faqen 5, një qartësim po dëshiroj me bo, tek Edukimi përmendën këtu në shkollat e mesme janë të përfshirë rreth 10 nxënës në zonat urbane dhe rurale ndërsa në shkollat fillore rreth 230 nxënës, do të thotë është fjala për nxënës minoritarë apo, nëse janë minoritarë a përfshihen të gjithë në RAE, a janë edhe serbët sepse aty përfshihen edhe komuniteti minoritarë serbë, këtë desha me ditë. Faleminderit!

Lendrit Qeli – Faleminderit kryesues, vetëm sa të sqarohem, meqenëse me kthim të qëndrueshëm kemi të bëjmë me pjesëtarë të komunitetit serbë që shumica prej tyre janë nga komuniteti serbë 99%, këto statistika i dedikohen kryesisht komunitetit serbë, pra ka të bëjë me fëmijët e komunitetit në fjalë.

Kryesuesi – Faleminderit Lendrit, tjetër dikush? Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatoj se kalon për Kuvend edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë:

7. Të ndryshme - A ka dikush diçka? Nëse nuk ka, atëherë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë. Mbledhjen e Kuvendit planifikojmë ta kemi me datën 27.11.2019 të këtij muaji, për shkak të festave të Nëntorit që tash janë, gjithashtu ju ftoj për kafe të gjithëve. Faleminderit!

Procesmbajtësi


Agim Hoti

